Vendim nr. 292, datë 17.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 17.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 48 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARBEN KASTRATI,** përfaqësuar nga avokati Shaban Nexhi dhe Kaludjon Laska, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1833, datë 02.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 30, 32, pika 2, 42, 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e punonjësit të Policisë Kufitare në pikën e kalimit kufitar Morinë, Kukës. Ai është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*),nën dyshimin se, në bashkëpunim me punonjës të tjerë të Policisë Kufitare, ka qenë pjesë e një skeme të vazhdueshme korruptive të kërkimit dhe marrjes së ryshfetit nga shtetas të ndryshëm në këmbim të lehtësimit të kalimit kufitar, duke siguruar përfitime financiare që varionin nga 5 euro deri në 400 euro për rast. Sipas organit të akuzës, kjo veprimtari organizohej në nivel turni, ku përgjegjësi i turnit përzgjidhte punonjësit, koordinonte mënyrën e funksionimit të skemës dhe, në përfundim të shërbimit, ngarkonte një kontrollor me mbledhjen e shumave të përfituara. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme ka pretenduar se kërkuesi, nën ndikimin e eprorit të tij, ka shmangur regjistrimin në sistemin TIMS të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë.

2. Në përfundim të hetimit, prokuroria e ka akuzuar kërkuesin për veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 259, paragrafi i parë, dhe 25 të Kodit Penal (*KP*). Në vijim, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, e cila është pranuar nga gjyqtari i seancës paraprake me vendimin e datës 02.12.2022.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka pranuar kërkesën e kërkuesit për gjykim të shkurtuar. Me vendimin nr. 15, datë 21.02.2023, ajo e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike dhe, pas uljes së dënimit me një të tretën, në zbatim të nenit 406, paragrafi i parë, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), e ka dënuar atë me 1 vit e 4 muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të KP-së, gjykata ka pezulluar ekzekutimin e pjesës së pavuajtur të dënimit, duke e vënë kërkuesin në provë për një periudhë prej 2 vjetësh e 8 muajsh, si dhe i ka hequr të drejtën për të ushtruar funksione publike për 5 vjet. Sipas gjykatës, provat e administruara mbështesnin përgjegjësinë penale të kërkuesit, i cili, në bashkëpunim me kolegen e tij V.S., në ngjarjen e datës 15.02.2022 dhe i vetëm në episodet e tjera, gjatë ushtrimit të detyrës së tij në pikën e kalimit kufitar Morinë, ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij në këmbim të lejimit të kalimit kufitar, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm.

4. Kërkuesi ka paraqitur apel, por Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 50 (87-2023-216), datë 22.11.2023, e ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke ndryshuar vetëm kohëzgjatjen e

periudhës së provës, të cilën e ka caktuar në masën e dyfishit të pjesës së pavuajtur të dënimit. Më pas, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1833, datë 02.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

5. Në datën 29.05.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 08.06.2026.

6. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara i janë cenuar:

7.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi Prokuroria e Posaçme nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme se kërkuesi ka kryer veprimin e kundërligjshëm. Po ashtu, mungon elementi thelbësor i anës objektive, që konsiston në kërkimin e premtimit ose marrjen e një përfitimi për vete ose për të tjerë, ose pranimin e një oferte nga një subjekt i jashtëm, i cili premton ose ofron një përfitim të paligjshëm. Nga pamjet audio dhe video dhe bisedat e transkriptuara nuk rezulton të jetë provuar se kërkuesi ka kërkuar premtimin ose marrjen e një përfitimi për veten ose për persona të tjerë. Për më tepër, në pamjet filmike dhe procesverbalet e këqyrjes së tyre përdoren termat "në dukje", "nuk pasqyrohet qartë" dhe "nuk janë identifikuar", ndërsa edhe për kartëmonedhën Prokuroria e Posaçme ka konkluduar se ishte "në dukje kartëmonedhë 5 euro", pa u provuar nëse ajo ishte e vërtetë ose fiktive. Për rrjedhojë, Prokuroria e Posaçme nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme se kërkuesi ka kryer efektivisht veprimin e kundërligjshëm dhe nuk mund të konkludohet se vepra penale është konsumuar prej tij në të gjitha elementet e saj. Gjykata e Posaçme e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë marrë në konsideratë pretendimet e kërkuesit të parashtruara përkatësisht në ankim dhe

rekurs dhe nuk kanë konstatuar se këto dyshime duhet të shkojnë në favor të tij, jo të merren si bazë nga e cila buron fajësia. Gjykatat duhej të arsyetonin në kuadrin e mosprovueshmërisë së fajësisë, pasi pranimi i këtyre dyshimeve si prova përbën prezumim fakti të paarsyeshëm. Për rrjedhojë, fajësia e kërkuesit nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe vendimet e gjykatave të posaçme, në unison me vendimin e Gjykatës së Lartë, cenojnë parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë.

7.2. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, e parashikuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi kërkuesi ka kërkuar gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në ankim që materialet e marra nga sistemi TIMS të mos pranohen si prova mbi të cilat ngrihet akuza. Gjykata e Lartë, në unison me gjykatat e posaçme, nuk i ka marrë në konsideratë këto pretendime dhe as ka analizuar arsyet përse ato janë të pabazuara. Prokuroria e Posaçme nuk ka dhënë prova se oficerët e Policisë Gjyqësore, gjatë përpunimit të këtyre të dhënave, plotësonin kërkesat ligjore dhe kërkuesit nuk i është vënë në dispozicion dokumenti i lëshuar nga autoriteti gjyqësor për sigurimin në rrugë ligjore të tyre. Po kështu, nuk është vërtetuar nëse sistemi TIMS është i certifikuar nga autoritetet kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe sa është masa e marzhit të gabimit në përqindje.

7.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar mbi episodet dhe provat, nga të cilat ka deduktuar përgjegjësinë e kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit vetëm ka ricituar atë çfarë ka arsyetuar GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pa arsyetuar se përse pretendimet e ankuesit ishin të pabazuara. Argumentet e saj nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur pjesën urdhëruese të vendimit dhe mungon një arsyetim koherent dhe logjik në arsyetimin e provave. Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar dhe analizuar shkaqet e rekursit të kërkuesit, por është mjaftuar me citimin formal të pretendimeve të tij, duke i konsideruar ato si pretendime që lidhen me provat dhe faktet. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është formal dhe nuk plotëson kriteret minimale ligjore, duke cenuar të drejtën e kërkuesit për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

8. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes mund të vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete. Për rrjedhojë, verifikimi i mospërmbushjes edhe vetëm të një kriteri është i mjaftueshëm për të sjellë si pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit *ratione materiae* të kërkuesit që ka të bëjë me natyrën kushtetuese të pretendimeve të tij.

10. Në këndvështrim të përmbushjes së këtij kriteri, i cili verifikohet në drejtim të natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, vërehet se, ndonëse në objektin e ankimit kushtetues kundërshtohet vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në përmbajtje të tij kërkuesi ka ngritur pretendime edhe ndaj vendimeve të gjykatave të faktit. Kërkuesi ka pretenduar se për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat e zakonshme në rastin konkret atij i është cenuar: (i) *parimi i prezumimit të pafajësisë;* (ii) *e drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*; (iii) *standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Këto pretendime janë të tilla që *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohen në vijim.

11. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë,* kërkuesi ka parashtruar se Prokuroria e Posaçme nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për të provuar fajësinë e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe nuk ka verifikuar nëse ai ka kërkuar ose marrë ryshfet. Sipas kërkuesit, nuk është provuar elementi thelbësor i anës objektive të veprës penale, që

konsiston në kërkimin e premtimit ose marrjen e një përfitimi për vete ose për të tjerë, pasi kjo nuk rezulton nga pamjet audio dhe video dhe bisedat e transkriptuara. Ai ka pretenduar se gjykatat u kanë dhënë vlerë këtyre provave, ndonëse ato shoqërohen me termat "në dukje", "nuk pasqyrohet qartë" dhe "nuk janë identifikuar", si dhe marrjes së një kartëmonedhe 5 euro pa verifikuar arsyen e marrjes së saj. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit dyshimet duhet të shkonin në favor të tij, pasi fajësia nuk është vendosur tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

12. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Mbi bazën e këtyre standardeve, Kolegji do të verifikojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë individualizuar në mënyrë të mjaftueshme faktet penale dhe përgjegjësinë e kërkuesit, kanë identifikuar dhe vlerësuar provat mbi të cilat kanë mbështetur përfundimet e tyre, si dhe nëse arsyetimi i tyre mbështet konkluzionin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

14. Paraprakisht, Kolegji vë në dukje se çështja e kërkuesit, mbi bazën e kërkesës së tij, është shqyrtuar sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar. Përmes zgjedhjes së kësaj procedure ai ka pranuar që çështja të zgjidhej në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet e hetimit paraprak, duke hequr dorë nga administrimi i provave sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm dhe nga mundësia për të paraqitur prova dhe për të thirrur dëshmitarë. Gjithashtu, nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij nuk kanë ngritur pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose për papërdorshmërinë e provave dhe nuk kanë kërkuar administrimin e provave të reja (*shih vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqet 35-37*).

15. Për sa i takon shqyrtimit të themelit të akuzës, Kolegji vëren se Prokuroria e Posaçme ka dërguar në gjyq kërkuesin dhe 31 të bashkëpandehur të tjerë, të akuzuar se për shkak të detyrës së tyre si punonjës policie (trupë shërbimi fizik) në pikën e kalimit kufitar Morinë, në këmbim të ryshfetit ose përfitimeve të tjera të parregullta, nuk regjistronin kalimin e shtetasve dhe mjeteve të

tyre, nuk kontrollonin dokumentacionin përkatës ose ushtronin kontrolle të pajustifikuara ndaj shtetasve që kalonin kufirin, me qëllim përfitimin e shumave monetare. Për sa i takon kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se nga vlerësimi në unitet i provave të administruara në gjykim, konkretisht: (i) pamjeve audio dhe video të regjistruara në datat 15.02.2022 dhe 23.02.2022; (ii) bisedave të transkriptuara të komunikimeve të zhvilluara; (iii) të dhënave të marra nga sistemi TIMS; (iv) procesverbaleve të këqyrjes së pamjeve filmike, provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi, gjatë ushtrimit të detyrës si "trup shërbimi fizik" në pikën e kalimit kufitar Morinë, ka konsumuar elementet e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 259 i KP-së, në bashkëpunim, sipas nenit 25 të tij. Sipas gjykatës, kërkuesi ka kërkuar dhe marrë shuma parash nga shtetasit e përpunuar prej tij, kundrejt lejimit të kalimit të tyre në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm (*shih vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, paragrafët 645 dhe 652*).

16. Në këtë drejtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nga analiza e provave, të vlerësuara në unitet me njëra-tjetrën, është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi, gjatë ushtrimit të detyrës si "trup shërbimi fizik" në pikën e kalimit kufitar Morinë, në ngjarjet e datave 15.02.2022 dhe 23.02.2022, ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 259 i KP-së, në bashkëpunim, sipas nenit 25 të tij. Duke iu referuar nenit 152, pika 2, të KPP-së, ajo ka çmuar se indicet janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Mbi këtë bazë, ajo ka analizuar në mënyrë të individualizuar episodet e datave 15.02.2022 dhe 23.02.2022, duke përcaktuar për secilin prej tyre veprimet që i atribuohen kërkuesit dhe provat ku mbështeten përfundimet e saj.

17. Në lidhje me episodin e datës 15.02.2022, gjykata është mbështetur në pamjet filmike dhe regjistrimet audio-video, bisedat e transkriptuara, procesverbalet e këqyrjes dhe të dhënat e sistemit TIMS. Sipas saj, dokumentohet marrja e një kartëmonedhe 5 euroshe gjatë përpunimit të dokumenteve të disa shtetasve kosovarë, kundrejt tolerimit të mungesës së testeve të vaksinimit kundër COVID-it; marrja dhe fshehja e një kartëmonedhe euro me prerje të paqartë gjatë përpunimit të një shtetasi kosovar të paidentifikuar; kërkimi dhe marrja, së bashku me kolegen V.S., e një shume eurosh kundrejt mosbërjes së shënimit në pasaportë për tejkalimin e kohës së qëndrimit në vendet e BE-së; marrja e një shume parash gjatë përpunimit të shtetasve me mungesa në dokumentet e vaksinimit, letërnjoftimit dhe autorizimit për përdorimin e automjetit.

18. Gjithashtu, për ngjarjet e datës 23.02.2022, gjykata ka arsyetuar se biseda ndërmjet kërkuesit dhe të pandehurit B.D. për marrjen e shumës 10 euro nuk konfirmohet nga prova të tjera dhe nuk mund të lokalizohet në kohë dhe hapësirë, ndaj nuk mund të konkludohet përtej çdo

dyshimi të arsyeshëm se punonjësit kanë kërkuar, marrë ose pranuar përfitim të kundërligjshëm. Po kështu, ndonëse kërkuesi rezulton i pranishëm në episodin ku G.D. merr një shumë parash, nuk rezultojnë veprime të tij në drejtim të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale. Ndërsa në episodin e orës 18:38, gjykata ka vlerësuar se kërkuesi ka përpunuar dy karta identiteti, megjithëse në sportel është paraqitur vetëm një shtetas, dhe ka marrë nga shtetasi B.H. shumën prej 50 eurosh, të cilën e ka futur në xhep. Sipas gjykatës, këto veprime përmbajnë elementet e anës objektive, pasi kërkuesi ka kërkuar në mënyrë të tërthortë, marrë dhe pranuar shuma monetare kundrejt tolerimit të kalimit të shtetasve në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion dhe mosregjistrimit të tyre në sistemin TIMS.

19. Për sa i përket rrethanës së kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, sipas nenit 25 të KP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në episodin e datës 15.02.2022 veprimet janë kryer në bashkëpunim me V.S., përmes veprimeve të përbashkëta dhe komplementare dhe një marrëveshjeje të heshtur të arritur aty për aty. Në lidhje me anën subjektive, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se veprimet janë kryer me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimi, pasi kërkuesi ka qenë i vetëdijshëm për sjelljen e kundërligjshme dhe ka kërkuar, marrë dhe pranuar shuma monetare kundrejt mospërmbushjes së rregullt të detyrës. Po ashtu, në vlerësimin e asaj gjykate, kërkuesi plotëson edhe kushtin e posaçëm të subjektit të veprës penale, pasi, si punonjës i Policisë Kufitare dhe Migracionit në pikën e kalimit kufitar Morinë, ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publik të njohur nga ligji.

20. Ky vlerësim është konfirmuar edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila, pas vlerësimit në tërësi të pamjeve audio dhe video të regjistruara në datat 15.02.2022 dhe 23.02.2022, bisedave të transkriptuara, të dhënave të sistemit TIMS dhe procesverbaleve të këqyrjes së pamjeve filmike, ka çmuar se fajësia e kërkuesit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas saj, kërkimi në mënyrë të tërthortë, marrja dhe pranimi i shumave monetare kundrejt tolerimit të kalimit të shtetasve në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion dhe, në disa raste, pamundësisë së regjistrimit të tyre në sistemin TIMS, përmbushin elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i KP-së. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimi, ndërsa në episodin e datës 15.02.2022, ora 16:03, bashkëpunimi me V.S. është realizuar përmes veprimeve të përbashkëta dhe komplementare, mbi bazën e një marrëveshjeje të heshtur të arritur aty për aty. Ajo ka çmuar, gjithashtu, se kërkuesi plotëson kushtet për të qenë subjekt i posaçëm i veprës penale, pasi, si punonjës i Policisë Kufitare dhe Migracionit në pikën e kalimit kufitar Morinë, ka ushtruar funksion publik dhe ka zotëruar autoritet publik të njohur nga ligji (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqet 225-228*).

21. Ky arsyetim nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka çmuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore që të vinin në diskutim vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Ajo ka theksuar sesi gjykatë ligji ushtron juridiksion vetëm mbi shkaqet e rekursit të parashikuara në nenin 432 të KPP-së dhe se pretendimet që lidhen me rivlerësimin e fakteve dhe të provave nuk përfshihen në kompetencën e saj. Njëkohësisht, ajo ka sqaruar se kontrolli i saj shtrihet mbi zbatimin e drejtë të ligjit material e procedural dhe mbi respektimin e standardeve të një vendimmarrjeje të arsyetuar. Po sipas Gjykatës së Lartë, pretendimet që lidhen me provueshmërinë e akuzës, ekzistencën e elementeve të veprës penale dhe respektimin e standardeve të procesit penal nuk kanë evidentuar asnjë shkelje të ligjit material ose procedural që të justifikojnë cenimin e vendimit të kundërshtuar (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafi 40*).

22. Nga vlerësimi i arsyetimit të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Kolegji çmon se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ato gjykata kanë individualizuar përgjegjësinë e tij penale. Ato e kanë deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, të kryer në bashkëpunim me të pandehurën V.S. në episodin e datës 15.02.2022, ora 16:03, dhe i vetëm në episodet e tjera të provuara. Njëkohësisht, ato nuk kanë çmuar të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm episodin që lidhej me bisedën ndërmjet kërkuesit dhe B.D. për marrjen e shumës 10 euro, për shkak se kjo bisedë nuk konfirmohej nga prova të tjera dhe nuk mund të lokalizohej në kohë dhe hapësirë. Po kështu, ato nuk kanë konstatuar veprime të kërkuesit në drejtim të pjesëmarrjes në episodin ku i pandehuri G.D. kishte marrë një shumë parash. Për sa u përket shprehjeve "në dukje" dhe "nuk pasqyrohet qartë" të evidentuara nga kërkuesi, Kolegji vëren se në episodin e marrjes së kartëmonedhës 5 euro, ajo që nuk evidentohet qartë është komunikimi lidhur me arsyen e dhënies së saj, ndërsa në episodin e marrjes dhe fshehjes së një kartëmonedhe euro, paqartësia lidhet me prerjen e kartëmonedhës dhe jo me faktin që ishte kartëmonedhë euro. Në kontekstin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, paqartësia lidhet me vlerën ose prerjen e kartëmonedhës dhe jo me faktin e marrjes së saj.

23. Në këtë drejtim, gjykatat kanë shpjeguar se përfundimet mbi fajësinë nuk mbështeteshin në prova të izoluara, por në vlerësimin në unitet të pamjeve audio dhe video të regjistruara në datat 15.02.2022 dhe 23.02.2022, bisedave të transkriptuara, të dhënave të sistemit TIMS dhe procesverbaleve të këqyrjes së pamjeve filmike, të analizuara në raport me detyrimet e përcaktuara nga ligji nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar". Mbi këtë bazë, ato kanë arsyetuar se kërkuesi ka kërkuar në mënyrë të tërthortë, marrë dhe pranuar shuma monetare kundrejt tolerimit

të kalimit të shtetasve në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion dhe, në disa raste, pamundësisë së regjistrimit të tyre në sistemin TIMS, duke konsumuar elementet e anës objektive dhe subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i KP-së. Ato kanë arsyetuar se provat e administruara ishin të mjaftueshme për të provuar fajësinë e kërkuesit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për rrjedhojë, mënyra sesi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuesit nuk ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, ndaj pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

24. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme,* kërkuesi ka parashtruar se të dhënat e marra nga sistemi TIMS janë siguruar në kundërshtim me ligjin nr. 8792, datë 10.05.2001 "Për krijimin e qendrës së përpunimit të të dhënave". Sipas tij, Prokuroria e Posaçme nuk ka dhënë prova se oficerët e Policisë Gjyqësore, gjatë përpunimit të këtyre të dhënave, plotësonin kërkesat ligjore dhe kërkuesit nuk i është vënë në dispozicion dokumenti i lëshuar nga autoriteti gjyqësor për sigurimin në rrugë ligjore të tyre. Po kështu, sipas tij, nuk është vërtetuar nëse sistemi TIMS është i certifikuar nga autoritetet kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe sa është masa e marzhit të gabimit në përqindje dhe gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në ankim është kërkuar që këto të dhëna të mos pranohen si prova mbi të cilat ngrihet akuza. Edhe Gjykata e Lartë, pretendon kërkuesi, nuk i ka marrë në konsideratë këto pretendime dhe nuk ka analizuar arsyet përse ato janë të pabazuara.

25. Neni 32, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtën për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Nën frymën e kësaj dispozite, Gjykata ka theksuar se asnjë gjykatë nuk ka mundësi që, pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme (*shih vendimet nr. 55, datë 10.10.2025; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës, si dhe për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre. Po kështu, Gjykata ka theksuar se, kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata e zakonshme mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen. Gjithashtu, nuk është detyrë e Gjykatës të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë e kërkuesit edhe mbi disa prova të tjera (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 40, datë 22.09.2011; nr. 42, datë 18.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Kolegji vëren se vendimet e gjykatave të faktit për deklarimin fajtor të kërkuesit janë bazuar në disa prova, si: (i) pamjet audio dhe video të regjistruara në kabinën ku ai ushtronte detyrën në pikën kufitare të Morinës në datat 15.02.2022 dhe 23.02.2022; (ii) procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike dhe të transkriptimit të bisedave; (iii) të dhënat e marra nga sistemi TIMS të përdorura kryesisht si provë verifikuese e rrethanave të episodeve konkrete, pra për të kontrolluar situatën e shtetasve që paraqiteshin në kufi dhe nëse veprimet e konstatuara nga përgjimet/pamjet filmike përputheshin me të dhënat e hyrje-daljeve. Nga vlerësimi në unitet i këtyre provave, gjykatat kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ka kërkuar në mënyrë të tërthortë, marrë dhe pranuar shuma monetare nga shtetasit e përpunuar prej tij, kundrejt tolerimit të kalimit të tyre në kufi, pavarësisht mangësive në dokumentacion dhe, në disa raste, pamundësisë së regjistrimit të tyre në sistemin TIMS, veprime që përmbushin elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 259 i KP-së, ndërsa kërkuesi ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimi. Gjykatat kanë analizuar episodet që lidhen me: (i) marrjen e kartëmonedhës me vlerë 5 euro gjatë përpunimit të shtetasve kosovarë, kundrejt tolerimit të tyre pa iu kërkuar testet lidhur me vaksinimin kundër COVID-it; (ii) marrjen dhe fshehjen e një kartëmonedhe euro me prerje të paqartë gjatë përpunimit të dokumenteve të një shtetasi kosovar të paidentifikuar; (iii) kërkimin dhe marrjen, në bashkëpunim me kolegen V.S., të një shume eurosh kundrejt mosbërjes së shënimit në pasaportë për tejkalimin e kohës së qëndrimit në vendet e BE-së; (iv) marrjen e një shume parash gjatë përpunimit të shtetasve me mungesa në dokumentacion; (v) marrjen e shumës prej 50 eurosh nga shtetasi B.H., pasi kërkuesi kishte përpunuar dy dokumente, megjithëse njëri nga shtetasit nuk ishte paraqitur fizikisht në pikën e kalimit kufitar.

27. Për sa i përket të dhënave të marra nga sistemi TIMS, kërkuesi ka pretenduar papërdorshmërinë e tyre, me argumentin se ato janë marrë në kundërshtim me ligjin nr. 8792, datë 10.05.2001 “Për krijimin e qendrës së përpunimit të të dhënave”, pasi Prokuroria e Posaçme nuk ka dhënë prova se oficerët e Policisë Gjyqësore, gjatë përpunimit të këtyre të dhënave, plotësonin kërkesat ligjore dhe kërkuesit nuk i është vënë në dispozicion dokumenti i lëshuar nga autoriteti gjyqësor për sigurimin në rrugë ligjore të tyre.

28. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vëren se, sipas KPP-së, provat janë të papërdorshme kur janë marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se të dhënat e marra nga sistemi TIMS janë siguruar në shkelje të ndonjë ndalimi të parashikuar nga ligji dhe as ka evidentuar konkretisht dispozitën ligjore që ndalon marrjen ose përdorimin e këtyre të dhënave në procesin penal. Kolegji vlerëson

se Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e funksioneve të saj në kuadër të procedimit penal, ka akses në të dhënat e sistemit TIMS dhe mund t'i përdorë ato për qëllime të procesit penal. Sipas ligjit nr. 8792, datë 10.05.2001, "Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave", autoriteti gjyqësor mund të marrë të dhëna dhe informacione vetëm për verifikimet e nevojshme në procedime penale të filluara dhe brenda kufijve të KPP-së. Bazuar në këto parashikime dhe mënyrën sesi ka vepruar Prokuroria e Posaçme në rastin konkret nuk rezulton që veprimet për marrjen e këtyre të dhënave dhe paraqitjen e tyre si prova në gjykim të bien ndesh me ndonjë ndalim të parashikuar shprehimisht nga ligji. Po kështu, Kolegji vëren se këto të dhëna janë përdorur nga gjykatat për verifikimin e identitetit të shtetasve, orarit dhe rrethanave të kalimit të tyre kufitar dhe janë vlerësuar në unitet me provat e tjera të administruara gjatë gjykimit, konkretisht pamjet audio dhe video të regjistruara në datat 15.02.2022 dhe 23.02.2022, bisedat e transkriptuara dhe procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike. Për rrjedhojë, për sa kohë që nuk konstatohet shkelje e ndonjë dispozite ligjore me pasojë pavlefshmërinë e vetë këtyre provave, nuk ka vend për të vënë në diskutim vendimmarrjet e kundërshtuara vetëm për këtë shkak. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme është haptazi i pabazuar.

29. Lidhur me pretendimin për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar dhe analizuar shkaqet e rekursit, por është mjaftuar me citimin formal të pretendimeve të tij, duke i konsideruar ato si pretendime që lidhen me provat dhe faktet. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit, arsyetimi i Gjykatës së Lartë është formal dhe nuk plotëson kriteret minimale ligjore, duke cenuar të drejtën e tij për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

30. Gjykata ka pranuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes *(shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata është shprehur se vendimet e Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese).*

31. Mbi bazën e këtyre standardeve, Kolegji do të verifikojë nëse gjykatat e faktit kanë dhënë mjaftueshëm arsye për fajësinë e kërkuesit dhe nëse arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë ka identifikuar arsyet e mospranimit të rekursit për t'u konsideruar i mjaftueshëm në aspektin kushtetues.

32. Kolegji konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka analizuar episodet e datave 15.02.2022 dhe 23.02.2022, si dhe provat ku ka mbështetur përgjegjësinë penale të kërkuesit, konkretisht pamjet audio dhe video, bisedat e transkriptuara, të dhënat e sistemit TIMS dhe procesverbalet e këqyrjes së pamjeve filmike. Ajo ka arsyetuar për veprimet e kërkuesit në secilin episod, dallimin ndërmjet episodeve të provuara dhe atyre që nuk provoheshin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, si dhe për elementet e anës objektive dhe subjektive të veprës penale, bashkëpunimin, qëllimin dhe cilësinë e tij si subjekt i posaçëm. GJKKO-ja e Apelit, pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankim, ka vlerësuar në unitet provat e administruara dhe ka arsyetuar se ato provojnë fajësinë e kërkuesit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ajo ka trajtuar edhe pretendimet për ligjshmërinë dhe përdorshmërinë e pamjeve filmike, duke vlerësuar se pajisjet video-përgjuese janë vendosur në ambiente publike dhe se veprimi është autorizuar nga prokurori në përputhje me nenin 221, pika 2, dhe nenin 222, pika 8, të KPP-së. Për rrjedhojë, pamjet filmike dhe procesverbalet e transkriptimit të tyre janë vlerësuar si prova të përdorshme dhe arsyetimi i gjykatave të faktit nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar në kuptimin kushtetues. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji, ka dhënë një arsyetim të kufizuar, duke shpjeguar se pretendimet që kërkonin rivlerësimin e provave dilnin jashtë juridiksionit të saj dhe se gjykata e apelit u kishte dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të ngritura në rekurs. Ajo ka paraqitur në pjesën hyrëse të vendimit rrethanat e çështjes, ka përmbledhur vendimmarrjen e gjykatave të faktit dhe ka evidentuar shkaqet e rekursit të paraqitura nga secili prej të pandehurve, përfshirë edhe kërkuesin. Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve që hynin në juridiksionin e saj dhe arsyetimi i saj bën të mundur kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit, i lexuar së bashku me paraqitjen e shkaqeve të rekursit dhe arsyetimin e gjykatave të faktit, i bën të identifikueshme arsyet e mospranimit. Për rrjedhojë, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të jetë mjaftuar vetëm me citimin formal të pretendimeve të kërkuesit, ndërsa arsyetimi i kufizuar i saj, në kushtet e mospranimit të rekursit, përmban arsyet për të cilat shkaqet e ngritura prej tij nuk janë konsideruar të tilla që të vinin në diskutim vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Në këto rrethana, fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk përbën, në vetvete, një element që vë në dyshim drejtësinë e procedurës së ndjekur ose pajtueshmërinë e saj me garancitë

kushtetuese të procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.